

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pml-Kzz nr. 194/2013

2 prill 2014

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari Bertil Ahnborg si kryetar i kolegjit dhe gjyqtar raportues, dhe gjyqtarët Salih Toplica dhe Gyltene Sylejmani si anëtarë të kolegjit, në prani të Këshilltares ligjore Lendita Berisha, duke vepruar në cilësi të procesmbajtëses,

Në procedurën penale kundër:

SA₁, Data e lindjes... me shtetësi të Kosovës,

I dënuar në shkallën e dytë me aktgjykimin e prerë të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap-kz nr.61/2012 të datës 2 tetor 2012, i shpallur fajtor për veprat penale Krim i organizuar në kundërshtim të nenit 274, paragrafit 4 të KPK-së në lidhje me veprën penale Kontabandim me migrantë në kundërshtim të nenit 138 paragrafit 6 në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së dhe i dënuar me shtatëmbëdhjetë (17) vite burgim dhe me gjobë prej 200.000 Euro;

I përfaqësuar në Gjykatën Supreme nga avokati mbrojtës FV;

FP, Data e lindjes... me shtetësi të Kosovës, I dënuar në shkallën e dytë me aktgjykimin e prerë të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap-kz nr.61/2012 të datës 2 tetor 2012, i shpallur fajtor për veprën penale Kontabandim me migrantë në kundërshtim të nenit 138 paragrafit 6 në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së dhe i dënuar me shtatë (7) vite burgim;

I përfaqësuar në Gjykatën Supreme nga avokati mbrojtës SP;

IK, Data e lindjes... me shtetësi të Kosovës, I dënuar në shkallën e dytë me aktgjykimin e prerë të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap-kz nr.61/2012 të datës 2 tetor 2012, i shpallur fajtor për veprat penale Krim i organizuar në kundërshtim të nenit 274, paragrafit 2 të KPK-së në lidhje me veprën penale Kontabandim me migrantë në kundërshtim të nenit 138 paragrafit 6 në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së dhe i dënuar me tetë (8) vite burgim;

I përfaqësuar në Gjykatën Supreme nga avokati mbrojtës QZ;

SS, Data e lindjes... me shtetësi të Kosovës,

I dënuar në shkallën e dytë me aktgjykimin e prerë të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap-kz nr.61/2012 të datës 2 tetor 2012, i shpallur fajtor për veprat penale Krim i organizuar në kundërshtim të nenit 274, paragrafit 2 të KPK-së në lidhje me veprën penale Kontabandim me migrantë në kundërshtim të nenit 138 paragrafit 6 në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së dhe i dënuar me tetë (8) vite burgim;

I përfaqësuar në Gjykatën Supreme nga avokati mbrojtës NT;

AH, Data e lindjes... me shtetësi të Kosovës

I dënuar në shkallën e dytë me aktgjykimin e prerë të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap-kz nr.61/2012 të datës 2 tetor 2012, i shpallur fajtor për veprat penale Krim i organizuar në kundërshtim të nenit 274, paragrafit 4 të KPK-së në lidhje me veprën penale Kontabandim me migrantë në kundërshtim të nenit 138 paragrafit 6 në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së dhe i dënuar me nëntëmbëdhjetë (19) vite burgim dhe me gjobë prej 250.000 Euro;

I përfaqësuar në Gjykatën Supreme nga avokatët mbrojtës BT dhe ZJ;

BA, Data e lindjes... me shtetësi të Kosovës,

I dënuar në shkallën e dytë me aktgjykimin e prerë të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap-kz nr.61/2012 të datës 2 tetor 2012, i shpallur fajtor për veprën penale Kontabandim me migrantë në kundërshtim të nenit 138 paragrafit 6 në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së dhe i dënuar me pesë (5) vite burgim;

I përfaqësuar ne Gjykatën Supreme nga avokati mbrojtës GK;

Duke **vepruar** në lidhje me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura nga avokatët mbrojtës FV në emër të pandehurit **SA₁**, avokati mbrojtës SP në emër të pandehurit **FP**, avokati mbrojtës QZ në emër të pandehurit **IK**, avokati mbrojtës NT në emër të pandehurit **SS**, avokatët mbrojtës BT dhe ŽJ në emër të pandehurit **AH** dhe avokati mbrojtës GK në emër të pandehurit **BA** kundër aktgjykimit Ap-Kz nr.61/2012 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 2 tetor 2012 dhe aktgjykimit P nr. 244/2010 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të datës 17 qershor 2011, dhe duke pasur parasysh mendimin e Prokurorisë së Shtetit të Kosovës (ZPShK-së) të paraqitur më 20 nëntor 2013, përkatësisht më 26 nëntor 2011.

Duke **vepruar** sipas nenit 435 paragrafit 1 dhe nenit 28 paragrafit 2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-së), në seancën e mbajtur më 2 prill 2014, lëshon këtë

AKTGJYKIM

Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura nga avokati mbrojtës FV në emër të pandehurit SA₁, avokati mbrojtës SP në emër të pandehurit FP, avokati mbrojtës QZ në emër të pandehurit IK, avokati mbrojtës NT në emër të pandehurit SS, avokatët mbrojtës BT dhe ŽJ në emër të pandehurit AH dhe avokati mbrojtës GK në emër të pandehurit BA kundër aktgjykimit Ap-Kz nr.61/2012 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 2 tetor 2012 dhe aktgjykimit P nr. 244/2010 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të datës 17 qershor 2011, refuzohen si të pabazuara.

ARSYETIM

I. Historia e procedurës

Më 13 shtator 2010, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzë kundër **SA₁, FP, IK, XH, SS, AH** dhe **RA**, për kryerjen e veprave penale Krim i organizuar në kundërshtim të nenit 274 paragrafit 4 në lidhje me nenin 23 të KPK-së dhe Kontrabandim me migrantë në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 138 paragrafit 6 në lidhje me nenin 23 të KPK-së pa hetimeve në lidhje me ngjarjet e natës në mes 14 dhe 15 tetorit 2009 ku pesëmbëdhjetë persona shtetas të Kosovës kanë vdekur gjatë kalimit të kufirit në mes të Serbisë dhe Hungarisë me barkë përmes lumit Tisa afër Suboticës (Serbi). Më 21 janar 2011, aktakuza është ngritur kundër **BA** duke e akuzuar atë për vepra të njëjta penale. Aktakuza është konfirmuar me aktvendimin **KA** nr.216/2010 të datës 19 tetor 2010.

Më 17 qershor 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka lëshuar aktgjykimin me të cilin:

Të pandehurit **SA₁** dhe **AH** janë shpallur fajtorë për veprat penale Krim i organizuar në kundërshtim të nenit 274 paragrafit 4 të KPK-së dhe Kontrabandim me migrantë në kundërshtim të nenit 138 paragrafit 6 në lidhje me nenin 23 të KPK-së. **SA₁**¹ është dënuar me dënim unik prej

¹ **SA₁** është dënuar me katërbëdhjetë (14) vite burgim dhe me gjobë prej 200.000 Euro për veprën Krim i organizuar në kundërshtim të nenit 274 paragrafit 4 të KPK-së; dhe me dy (2) vite burgim për secilin migrantë të kontrabanduara sa i përket veprës penale Kontrabandim me migrantë në bashkëkryerjen në kundërshtim të nenit 138 paragrafit 6 dhe nenit 23 të KPK-së.

shtatëmbëdhjetë (17) vite burgim dhe me gjobë prej 200.000 Euro, dhe **AH**² me dënim unik prej nëntëmbëdhjetë (19) vite burgim dhe me gjobë prej 250.000 Euro.

IK dhe **SS** janë shpallur fajtor për veprat penale Krim i organizuar në kundërshtim të nenit 274 paragrafit 2 të KPK-së dhe janë dënuar me tetë (8) vite burgim dhe secili prej tyre është liruar nga vepra penale Kontrabandim me migrantë në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 138 paragrafit 6 në lidhje me nenin 23 të KPK-së.

FP është shpallur fajtor për veprën penale Kontrabandim me migrantë në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 138 paragrafit 6 në lidhje me nenin 23 të KPK-së dhe është dënuar me shtatë (7) vite burgim³.

BA është shpallur fajtor për veprën penale Kontrabandim me migrantë në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 138 paragrafit 6 në lidhje me nenin 23 të KPK-së dhe është dënuar me pesë (5) vite burgim⁴.

Aktgjykimi është ankimuar brenda afatit ligjor nga avokatët mbrojtës të të pandehurve.

Më 2 shkurt 2012, Gjykata Supreme ka refuzuar ankesat e paraqitura nga avokatët mbrojtës dhe *ex officio* ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në lidhje me cilësimin juridik të veprave, si në vijim:

AH dhe **SA₁** janë shpallur fajtorë për veprat penale Krim i organizuar në kundërshtim të nenit 274 paragrafit 4 të KPK-së **ne lidhje** me veprën penale Kontrabandim me migrantë në kundërshtim të nenit 138 paragrafit 6 në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së. **IK** dhe **SS** janë shpallur fajtorë për veprat penale Krim i organizuar në kundërshtim të nenit 274 paragrafit 2 **ne lidhje** me veprën penale Kontrabandim me migrantë në kundërshtim të nenit 138 paragrafit 6 në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së. **FP** është shpallur fajtor për veprën penale Kontrabandim me migrantë në kundërshtim të nenit 138 paragrafit 6 **në lidhje** me paragrafin 1 të KPK-së. **BA** është shpallur fajtor për veprën penale Kontrabandim me migrantë në kundërshtim të nenit 138 paragrafit 6 në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së. Gjykata Supreme ka vërtetuar dënimet e shqiptuara me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut.

Avokatë mbrojtës të **SA₁**, **AH**, **IK**, **SS**, **FP** dhe **BA** kanë paraqitur kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjyqimeve të Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës Supreme.

Në kërkesat e tyre për mbrojtje të ligjshmërisë, avokatët mbrojtës pretendojnë në shkelje të dispozitave të ligjit penal dhe ligjit të procedurës. Mbrojtja i propozon Gjykatës Supreme që t'i anulojë aktgjykimet e kontestuara dhe lëndën ta kthejë në rigjykim. Si alternativë, mbrojtja e **IK** dhe **SS** kanë kërkuar nga Gjykata Supreme që t'i ndryshojë aktgjykimet e kundërshtuara duke i liruar të pandehurit, dhe mbrojtja e **SA₁** ka kërkuar nga Gjykata Supreme që ta liroj të pandehurin e saj nga vepra penale Krim i organizuar dhe ta dënoj atë vetëm për Kontrabandim me migrantë, apo t'i shqiptoj një dënim më të butë.

Më 20 nëntor 2013, përkatësisht më 26 nëntor 2011, Prokurori i Shtetit ka paraqitur propozimet duke propozuar që kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjyqimeve të refuzohen si të pabazuara.

II. Gjetjet e Gjykatës Supreme

² **AH** është dënuar me gjashtëmbëdhjetë (16) vite burgim dhe me gjobë prej 250.000 Euro në lidhje me veprën penale Krim i organizuar në kundërshtim të nenit 274 paragrafit 4 të KPK-së; dhe me dy (2) vite burgim për secilin migrantë të kontrabanduara sa i përket veprës penale Kontrabandim me migrantë në bashkëkryerjen në kundërshtim të nenit 138 paragrafit 6 dhe nenit 23 të KPK-së.

³ **FP** është dënuar me dy (2) vite burgim për secilin migrantë të kontrabanduara.

⁴ **BA** është dënuar me dy (2) vite burgim për secilin migrantë të kontrabanduara.

Gjatë vlerësimit të kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme ka konstatuar si ne vijim:

a. Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë janë të pranueshme. Kërkesat janë paraqitur pranë gjykatës kompetente në pajtim me nenin 454, paragrafin 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së)⁵ dhe brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 452, paragrafin 3 të KPPK-së.

b. Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë janë të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës paraprakisht i referohet nenit 432 të KPP (nenit 451 paragrafit 2 të KPPK-së), i cili përcakton se kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të paraqitet mbi bazën e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Prandaj, kontestimi i gjendjes faktike në këtë fazë të procedurës është i papranueshëm dhe gjykata do të kufizohet vetëm në vlerësimin e shkeljeve eventuale në interpretimin apo zbatimin e ligjit.

Sipas nenit 436 të KPP-së (neni 451 i KPPK-së), Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve të ligjit material apo të procedurës të cilat avokatët mbrojtës i pretendojnë. Përveç kësaj, gjatë vlerësimit të saj Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka gjetur shkelje procedurale në aktgjykimet e kundërshtuara të cilat duhet të merren parasysh *ex officio*.

Pretendimet e mbrojtjes në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë

Në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë avokatët mbrojtës kanë elaboruar temat në vazhdim, a) provat e papranueshme, b) se gjykatat në aktgjykimet e tyre kanë tejkaluar aktakuzën, c) se Gjykata Supreme si shkallë e dytë ka shkelë parimin *reformatio in peius* gjatë ri-cilësimit të veprave penale dhe shqiptimin e dënimeve të vetme. Përveç këtyre temave, janë bërë edhe pretendime tjera kundër aktgjykimëve të cilat do të komentohen në vazhdim. Siç do të sqarohet, ky kolegji nuk gjen asnjë pretendim të mbrojtjes të bazuar.

A. Shkeljet substanciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljet tjera të dispozitave të procedurës penale.

A. 1 Papranueshmëria e provave

a. Deklarata e MR

Avokatët mbrojtës pohojnë se gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë kanë bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 para.1 nën-par.8 të KPPK-së duke pranuar si provë dëshminë e dëshmitarit MR të dhënë në polici edhe pse të pandehurit dhe avokatët e tyre mbrojtës nuk kanë pasur mundësi që ta kundërshtojnë atë.

Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj të 2 tetorit 2012 paragrafët 16 - 19, ka adresuar këtë (çështje në hollësi. Sidoqoftë, është me rëndësi më të madhe të vërehet se Gjykata e Qarkut dhe gjithashtu edhe Gjykata Supreme në aktgjykimet e tyre nuk i kanë kushtuar rëndësi të madhe deklaratave të MR. Nga aktgjykimet nuk mund të përfundohet se ka konkluzione të bazuara në atë që ka thënë MR në Polici, madje as në masën më të vogël. Prandaj, ky kolegji nuk mund të konstatoj se janë shkelur të drejtat e të pandehurve.

Sa i përket pretendimit të mbrojtjes së SA₁ se gjykata nuk ka bërë vlerësimin e deklaratës se MR të nënshkruar para noterit në G me numër 3180, të datës 22 shkurt 2011 në të cilën thuhet se "*Nuk kam asnjë lidhje me vëllezërit SA₁ dhe BA*", kolegji ua bën me dije të pandehurit dhe mbrojtjes së tij se ligji përcakton qartë procedurën që duhet zbatuar kur dëshmitari jep dëshminë e tij/saj. Pasi

⁵ Ligji i procedurës i cili ka qenë në fuqi deri më 31 dhjetor 2012

dëshmitari jeton jashtë shtetit atëherë kjo është dashur të bëhej në përputhje me dispozitat që i rregullojnë procedurat për Ndihmë Juridike Ndërkombëtare. Duke marrë parasysh se dokumenti i paraqitur nga mbrojtja nuk ishte marrë në mënyrë të rregullt Gjykata Supreme pajtohet plotësisht me qëndrimin e gjykatave më të ulëta - duke mos dhënë asnjë koment lidhur me këtë.

Pretendimet se Gjykatat kanë bërë shkelje esenciale në lidhje me dëshmitë e MR janë të pabazuara.

b. Raportet e regjistrimit të thirrjeve telefonike

Avokati mbrojtës argumenton se aktgjykimet janë të bazuara në raporte të papranueshme të mesazheve të këmbjere dhe kontakteve telefonike, të siguruara me anë të masave të fshehta pasi ishin marrë në mënyrë retroaktive. Kolegji pajtohet plotësisht me gjetjet e Gjykatës Supreme në aktgjykimin e saj, paragrafët 20 - 23. Me asnjë dispozitë nuk ndalohet implementimi retroaktiv i urdhrat për masa të fshehta. Faktikisht, kështu duhet të vepohet në shumë situata: kur Policia është duke e hetuar një krim mund të jetë me rëndësi të madhe të zbulohet se çka i kane komunikuar njëri tjetrit te dyshuarit gjatë fazës së planifikimit. Prandaj kjo provë nuk ishte e papranueshme dhe nuk ka shkelje të procedurës penale.

c. Deklarata e SA₂

Mbrojtja e **BA** pretendon se deklarata e dëshmitarit SA₂ e dhënë në Polici është dashur të ndahet si provë e papranueshme në përputhje me nenin 156 paragrafin 2 të KPPK-së. Policia e kishte intervistuar dëshmitarin SA₂ gjatë hetimit. Dëshmitari dëshmoi edhe në shqyrtim gjyqësor ku për arsye të panjohura dha një version tjetër të dëshmisë. Gjykata e shkallës së parë gjatë vlerësimit të provave theksoi se dëshmia e dhënë gjatë hetimeve duhet të konsiderohet si e besueshme. Pasi gjatë shqyrtimit gjyqësor kishte mundësi që të kundërshtojë dëshmitari, Gjykata e Qarkut kishte plotësisht të drejtë ta mbështeste vlerësimin e saj në deklaratat e dëshmitarëve të dhëna në Polici. Prandaj, edhe nuk ka shkelje të procedurës.

A.2. Shkeljet e nenit 403 paragrafit 1 nën-paragrafit 10

Mbrojtja e **SA₁** pretendon se në kundërshtim me nenin 386 paragrafin 1 të KPPK-së, aktgjykimet e shkallës së parë dhe të dytë e kanë tejkaluar aktakuzën. Sipas tij dispozitivi i aktakuzës, të ndryshuar, përmban vetëm elemente të veprës penale të kontrabandimit me migrantë në bashkëkryerje sipas nenit 138, paragrafit 6 dhe nenit 23 të KPK-së.

Mbrojtja kishte bërë pretendime të tilla edhe më parë në shkallë të dytë të cilat Gjykata Supreme i ka konsideruar plotësisht në aktgjykimin e saj, paragrafët 25 - 31. Kolegji vëren se mbrojtja nuk ka parashtruar asgjë të re, përveç se pretendimet tani kanë të bëjnë edhe me shkallën e dytë. Megjithatë, kolegji gjen se pretendimet janë pa meritë. Dispozitivët e aktgjyqimeve të dy instancave janë thjesht qartësime dhe nuk e tejkalojnë aktakuzën. Përveç kësaj, dispozitivët janë në pajtim me arsyetimet e gjykatave.

A.3 Shkeljet e nenit 403 paragrafit 1 nën-paragrafit 11

Mbrojtja e **SS** dhe **IK** pretendon se aktgjykimi i shkallës së dytë bën shkelje të dispozitës së nenit 403, paragrafit 1, pikës 11 lidhur me nenin 417 të KPPK-së. Prokuroria publike nuk ka paraqitur ankesë ndaj aktgjykimin, prandaj gjykata ishte e kufizuar të vendosë në përputhje me ndalimin e dispozitave ligjore dhe ta respektojë institucionin "*reformatio in peius*". Megjithatë, Gjykata

Supreme e ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në dëm të të pandehurve pasi i ka shpallur fajtorë për veprën penale për të cilën ishin shfajësuar më parë.

Të pandehurit **SS** dhe **IK** janë shfajësuar me aktgjykim të gjykatës së shkallës së parë nga akuza për Kontrabandim me migrantë në bashkëkryerje nga neni 138 paragrafi 6 dhe neni 23 i KPK-së dhe janë shpallur fajtorë për kryerjen e veprës penale të Krimit të organizuar në kundërshtim të nenit 274 të KPK-së.

Gjykata Supreme e ndryshoi *sipas detyrës zyrtare* cilësimin juridik të veprës penale për të cilën të pandehuri janë shpallur fajtorë për kryerjen e veprës penale të Krimit të organizuar, në kundërshtim të nenit 274, paragrafit 2 të KPK-së, lidhur me veprën penale të Kontrabandimit me migrantë në kundërshtim të nenit 138 paragrafit 6, lidhur me paragrafin 1 të KPK-së.

Ndryshe nga avokatët mbrojtës, kolegji konsideron se ndryshimet në aktgjykimin e shkallës së dytë nuk janë bërë në dëm të të pandehurve.

Shprehja *krimi i organizuar* është një shprehje e gjerë që në vetvete mund të përmbajë një ose më shumë vepra të rënda penale. Nga përshkrimi faktik i aktakuzës kuptohet se të pandehurit kanë marrë pjesë aktivisht në organizimin kriminal, aktiviteti kryesor i të cilit ishte Kontrabandimi me migrantë. Edhe nga dispozitivi i aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut është mjaft e qartë se aktiviteti kriminal që të pandehurit e kryenin dhe për të cilin janë dënuar ishte Kontrabandimi me migrantë, edhe pse ishte nën "ombrellën" e cilësimit juridik *krimi i organizuar*. Ndryshimet e shkallës së dytë *sipas detyrës zyrtare* ishin të gjitha brenda komizës së përshkrimit faktik të aktiviteteve kriminale dhe ishin bërë vetëm për hatër të qartësisimit juridik. Asnjëri i pandehur nuk është dënuar për vepër tjetër ose më shumë në shkallë të dytë se në shkallë të parë. Këtu vlen të theksohet edhe se në aktgjykimet e tyre gjykatat nuk janë të obliguara nga propozimet e prokurorit sa i përket klasifikimit juridik të veprës (neni 286, paragrafi 2 i KPPK-së). Sipas këtij kolegji gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm në aktgjykimin lidhur me ndryshimet.

Në çeshtjen e njëjtë, mbrojtja e **SA₁**, **SS** dhe **IK** pretendon se aktgjykimi i shkallës së dytë është i paqartë, kundërthënës dhe nuk arsyeton mjaftueshëm ndryshimet në dispozitiv dhe në cilësimin juridik të aktgjykimit të shkallës së parë. Më tutje, i mungon përshkrimi i arsyeve në të cilat e ka bazuar vendimin, dhe i elementeve të veprës penale që përbën veprën penale dhe përgjegjësinë penale të të akuzuarit. Gjykata Supreme nuk do të komentojë më shumë lidhur me këtë por vetëm i referohet arsyetimit të saj më lartë.

A.4. Shkeljet e nenit 403 paragrafit 1 nën-paragrafit 12

a. Avokatët mbrojtës të **AH** mbrojnë qëndrimin se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së dytë është i pakuptueshëm, i paqartë, kundërthënës në vete. Avokatët mbrojtës argumentojnë se aktgjykimi i ka cilësuar veprimet e **AH** dhe **A₁** si bashkëkryerje. Kurse në pjesën e dispozitivit e cila përmban vendimin mbi dënimin e shqiptuar i pandehuri është dënuar për vepër penale e cila nuk është kryer në bashkëkryerje.

Gjykata Supreme e Kosovës vëren se gjykata e shkallës së dytë e ka shpallur të pandehurin **AH** fajtor për veprën penale të Krimit të organizuar në kundërshtim të nenit 274, paragrafit 4 të KPK-së

lidhur me veprën penale të Kontrabandimit me migrantë në kundërshtim të nenit 138 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së (aktgjykimi Ap-kz no.61/2012 i datës 2 tetor 2012, faqe 2, versioni në gjuhën angleze) dhe për këtë vepër penale është dënuar me nëntëmbëdhjetë (19) vjet burgim dhe 250.000 Euros gjobë (faqe 4, paragrafi 3 i aktgjykimit të njëjtë). Pas krahasimit të versionit të aktgjykimit në gjuhën angleze me atë në gjuhën shqipe përcaktohet se kjo çështje është ngritur me të drejtë nga mbrojtja pasi që në versionin në gjuhën shqipe i pandehuri është shpallur fajtor për veprën penale të përshkruar më lart të kryer në *bashkëkryerje*.

Sipas Ligjit mbi Kompetencat kjo lëndë është caktuar në kompetencë të gjyqtarëve të EULEX-it, dhe kryetari i trupit gjykues ishte një gjyqtar i EULEX-it, i cili ishte i obliguar ta shkruajë aktgjykimin. Aktgjykimi origjinal është në gjuhën angleze i cili e mbizotëron versionin e përkthyer në gjuhën shqipe. Mospërputhjet në mes versioneve në gjuhët angleze dhe atë shqipe konsiderohen gabime në përkthim. Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se në këtë lëndë dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është mjaft i qartë dhe nuk është në kundërtënie me vetveten.

b. Avokatët mbrojtës të **AH** pretendojnë në shkelje esenciale të procedurës penale në kundërshtim të nenit 403 paragrafit 2 nën-paragrafëve 1 dhe 2 të KPPK-ës të cilat i kanë bërë prokurori dhe trupi gjykues, sepse gjykata e shkallës së parë i ka pranuar disa pjesë të provave në fillim të shqyrtimit gjyqësor. Sipas mbrojtjes së **SA₁**, gjykata e shkallës së dytë ka vepruar gabimisht kur i ka trajtuar shkeljet esenciale bashkë (të përcaktuara me nenin 403 të KPPK-së) dhe shkeljet e ligjit penal (të përcaktuara me nenin 404). Të dy avokatët mbrojtës janë shumë kritikë se si kryetari i trupit gjykues intervenonte gjersa prokurori apo mbrojtja i merite dëshmitarët në pyetje, në kundërshtim me nenin 165 paragrafin 2 të KPPK-së.

Si Gjykata Supreme si shkallë e dytë, ky kolegji nuk mund të gjejë asnjë shkelje të ligjit të procedurës sepse Gjykata e Qarkut i ka pranuar provat në fillim të shqyrtimit gjyqësor. Kolegji plotësisht pajtohet me gjetjet e Gjykatës Supreme në aktgjykimin sa, paragrafin 42. Pretendimet e avokatit mbrojtës të **SA₁** përkitazi me atë se si i ka trajtuar shkeljet e pretenduara gjykata e shkallës së dytë të përcaktuara me nene të ndryshëm janë pa meritë.

Kolegji më tutje pajtohet plotësisht me Gjykatën Supreme si gjykatë e shkallës së dytë me gjetjet e saj lidhur me intervenimin e kryetarit të trupit gjykues gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve (shin aktgjykimin, paragrafin 44). Është e qartë se të drejtat e të pandehurve nuk janë shkelur në këtë rast.

B. Shkeljet e pretenduara të dispozitave të ligjit penal

Disa avokatë mbrojtës paraqesin pretendime të ndryshme kundër gjykatave lidhur me çështjen e përgjegjësisë penale, mungesën e elementeve të veprës penale lidhjen shkakore në mes të veprimeve të të pandehurit dhe të pasojave të tyre dhe se nuk janë plotësuar të gjitha kriteret për ta cilësuar veprën penale si krim të organizuar. Po ashtu cilësimet e tjera të gabuara të veprave penale janë përshkruar nga mbrojtja si të ishte shkelur parimi "*in dubio pro reo*". Shumica e argumentimeve ka të bëjë me faktet dhe me meritat e lëndës, të cilat nuk mund të shqyrtohen në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

Gjykata Supreme nuk konsideron se është e dobishme të hyhet në detaje të këtyre pretendimeve. Shumë nga këto çështje janë shqyrtuar dhe përgjigjur më parë, dhe për çështjet e tjera kolegji nuk gjen asnjë shkelje të kodit të procedurës, siç parashtrohet mbrojtja.

C. Mos zbatimi i rregullave për shqiptimin e dënimit unik

Disa avokatë mbrojtës pohojnë se Gjykatat e kanë shkelur ligjin me shqiptimin e dënimit. Shkeljet e pretenduara kanë të bëjnë me Gjykatën e Qarkut dhe Gjykatën Supreme si shkallë të dytë. Prandaj, për shembull, mbrojtja e **AH** pretendon në shkelje të ligjit nga *gjykata e shkallës së dytë* me pretendim se edhe pse gjykata e ka ndryshuar aktgjykimin sa i përket veprës penale ai është shpallur fajtor (duke vërtetuar se i pandehuri është fajtor për veprën penale të Krimit të organizuar në kundërshtim të nenit 274, paragrafit 4 të KPK-së lidhur me veprën penale të Kontrabandimit me migrantë në kundërshtim të nenit 138 paragrafi 6 1 të KPK-së) e ka vërtetuar në dëm të të pandehurit dënimin e caktuar nga gjykata e shkallës së parë edhe pse prokurori nuk ka paraqitur ankesë. Dhe se gjykata nuk ka arritur t'i mare parasysh rrethanat lehtësuese gjatë caktimit të dënimit.

Gjykata Supreme si gjykatë e shkallës së dytë në aktgjykimin e saj ka kritikuar me të drejtë mënyrën se si Gjykata e Qarkut e ka llogaritur dënimin për të pandehurit të cilët ishin dënuar me "dy vjet për secilin migrant" kur në dispozitiv ishin shpallur fajtorë vetëm për një krim (kontrabandim me migrantë) por janë dënuar për disa vepra penale. Gjykata e shkallës së dytë e ndryshoi dispozitivin *sipas detyrës zyrtare* dhe e shqiptoi një dënim të vetëm për secilin të pandehur. Është shumë e qartë se me këtë shkallë e dytë nuk ka shqiptuar asnjë dënim në dëm të të pandehurve. Të gjithë të pandehurit në të vërtetë janë dënuar njësoj sikurse në shkallë të parë dhe dënimet dhe gjobat e shqiptuara nuk janë më të gjata e as më të larta. Ri cilësimi i veprës dhe ri-llogaritja i dënimeve, siç e ka bërë gjykata e shkallës së dytë, në asnjë mënyrë nuk shkon në dëm të të pandehurve.

Përfundimi final i Gjykatës Supreme

Siç u tha më lart, ky kolegji konstaton se pretendimet e mbrojtjes janë pa meritë.

Kryetari i kolegjit:

Procesmbajtëse:

Bertil Ahnborg
Gjyqtar i EULEX-it

Lendita Berisha
Zyrtare ligjore

Anëtarët e kolegjit:

Salih Toplica
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

Gyltene Sylejmani
Gjyktare e Gjykatës Supreme

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pml-Kzz nr. 194/2013

2 prill 2014